



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	
Nr. Prot. Bi-Prot. Prot No.	01-4320/15
Data Datum Date	20.11.2015



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.11.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-02-3431/15, për zyrtarin e lartë z. Naser Shala, Anëtar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP) për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3431/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Naser Shala, Anëtar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP).**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është identifikuar se zyrtari e lartë z. Naser Shala, Anëtar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP) gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë ushtron funksionin e personit të autorizuar në biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 28.10.2015. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Naser Shala ka ardhur ne zyrat tona, ku nga zyrtaret e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet.

z. Naser Shala është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se ne biznesin në fjalë nuk zhvillon aktivitet por ka mbet i regjistruar ne ARBK-ë, por është zotuar se brenda afatit ligjore do të mundohet të kontaktoj me pronarin e këtij biznesi dhe do te kërkoj nga ai ta bëj ndryshimin e kërkuar dhe brenda afatit ligjor do të largohet nga pozita e personit te autorizuar ne këtë biznes.

Me datën 16.11.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Naser Shala nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin “Kameri Construktion-Sh.P.K- Dega ne Kosovë” me nr. biznesi 70581744.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lart z. Naser Shala, Anëtar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP), dukë u larguar nga pozita e personit te autorizuar ne biznesin privat dhe pasi janë krijuar rrëthana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Naser Shala, Anëtar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP), andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

